



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri:** KSC-CC-2019-07

**Vendosi:** Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese  
Gjykatës Vidar Stensland, Kryetar  
Gjykatës Roland Dekers  
Gjykatës Antonio Balsamo

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 13 janar 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Lënda:** Kërkesë referuese e Driton Lajçit drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese mbi ligjshmërinë e procedurës së marrjes në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi kërkesën referuese të Driton Lajçit në lidhje me  
procedurën e marrjes në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar**

---

**Parashtruesi**  
Driton Lajçi

**Prokurori i Specializuar**  
Xhek Smith

## Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

e përbërë nga

Vidar Stensland, kryetar

Roland Dekers, gjykatës

Antonio Balsamo, gjykatës

Pas kuvendimeve të zhvilluara në largësi me anë të mjeteve të komunikimit elektronik dhe kokë më kokë, shpall Vendimin e mëposhtëm

### I. PROCEDURA

1. Më 14 nëntor 2019, në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta"), z. Driton Lajçi ("Parashtruesi") i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese një kërkesë referuese të datës 13 nëntor 2019 ("kërkesa referuese")<sup>1</sup>. Parashtruesi përfaqësohet nga z. Tobi Kadman.

2. Më 15 nëntor 2019, në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi panelin e lartpërmendur për të vendosur në lidhje me kërkesën referuese.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-CC-2019-07, F00001, Kërkesë Referuese drejtuar panelit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ligjshmërinë e Procedurës së Intervistimit, publike me shtojca konfidenciale, 13 nëntor 2019 ("Kërkesa Referuese").

<sup>2</sup> KSC-CC-2019-07, F00002, Vendim për caktimin e gjykatësve në një Panel të Gjykatës Kushtetuese, publik, 15 nëntor 2019. Në lidhje me gjuhët e punës të kësaj procedure, shih KSC-CC-2019-07, F00005, Vendim mbi gjuhën e punës, publik, 18 janar 2019. Në lidhje me vendin e zhvillimit të kësaj procedure, shih KSC-CC-2019-05, F00007, Vendim për vendin e zhvillimit të procedurave para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 janar 2019; KSC-CC-2019-06, F00001, Kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në lidhje me referimet e parashtruara në përputhje me nenin 49 të Ligjit, publike, 18 janar 2019.

3. Më 15 nëntor 2019, në përputhje me rregullën 11 të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“Rregullorja e Punës”), Prokurori i Specializuar parashtrroi kërkesë për riklasifikimin e kërkesës referuese prej publike në konfidenciale.<sup>3</sup> Më 17 nëntor 2019, Parashtruesi dorëzoi përgjigjen,<sup>4</sup> përmes së cilës i kërkoi panelit ta refuzonte kërkesën për riklasifikim. Më 20 nëntor 2019, Paneli nxori përmbledhje të vendimit,<sup>5</sup> me të cilin refuzoi kërkesën për riklasifikim.

4. Më 2 dhjetor 2019, Prokurori i Specializuar dorëzoi përgjigjen ndaj kërkesës referuese.<sup>6</sup> Parashtruesi<sup>7</sup> dhe Prokurori i Specializuar<sup>8</sup> dorëzuan parashtrimet e tyre të mëtejshme përkatësisht më 9 dhe 17 dhjetor 2019.

## II. FAKTET

5. Më 25 shtator 2019, Parashtruesi mori një fletëthirrje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ku i kërkohet të paraqitet për marrje në pyetje. Në fletëthirrje thuhej se ekzistonin arsye për të besuar se Parashtruesi ishte përfshirë në kryerjen e një vepre penale.<sup>9</sup>

---

<sup>3</sup> KSC-CC-2019-07, F00003, Kërkesë e Prokurorisë për riklasifikimin e parashtrimit KSC-CC-2019-07/F00001, konfidenciale, 15 nëntor 2019; KSC-CC-2019-07, F00003, RED, Version publik i redaktuar i ‘Kërkesë e Prokurorisë për riklasifikimin e parashtrimit KSC-CC-2019-07/F00001’, 15 nëntor 2019, publik i redaktuar, 18 nëntor 2019.

<sup>4</sup> KSC-CC-2019-07, F00007, Përgjigje e mbrojtjes ndaj kërkesës së Prokurorisë për riklasifikimin e parashtrimit KSC-CC-2019-07/F00001, konfidenciale, 15 nëntor 2019.

<sup>5</sup> KSC-CC-2019-07, F00007, Përmbledhje e vendimit lidhur me kërkesën e Prokurorisë për riklasifikimin e parashtrimit KSC-CC-2019-07/F00001, publike, 20 nëntor 2019.

<sup>6</sup> KSC-CC-2019-07, F00008, Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës referuese të z. Driton Lajçi drejtuar panelit të Gjykatës Kushtetuese mbi ligjshmërinë e procedurës së marrjes në pyetje me shtojcat konfidenciale 1-3, publike me shtojca konfidenciale, 2 dhjetor 2019 (“Përgjigjja e ZPS-së”). Në lidhje me këtë, shih KSC-CC-2019-07, F00006, Njoftim në lidhje me parashtrimin e kundërpërgjigjes, publik, 18 nëntor 2019.

<sup>7</sup> KSC-CC-2019-07, F00009, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës referuese të z. Driton Lajçi drejtuar Gjykatës Kushtetuese, publike, 9 dhjetor 2019.

<sup>8</sup> KSC-CC-2019-07, F00012, Përgjigjja e Prokurorisë ndaj parashtrimit të protokolluar KSC-CC-2019-07/F00009, publike, 17 dhjetor 2019.

<sup>9</sup> Kërkesa referuese, para. 2.2-2.4; Përgjigjja e ZPS-së, para. 2, shtojca konfidenciale 1 (Fletëthirrja e datës 25 shtator 2019).

6. Më 13 tetor 2019, Parashtruesi i kërkoi ZPS-së që ta informonte për pretendimet konkrete kundër tij dhe t'ia bënte të njohura materialet mbi të cilat bazoheshin ato pretendime. Një ditë më pas, ZPS-ja e informoi Parashtruesin për dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës mbi bazën e të cilave po hetonte Parashtruesin dhe nuk pranoi t'ia bënte të njohur asnjë provë në lidhje me pretendimet.<sup>10</sup>

7. Më 17 tetor 2019, Parashtruesi, i shoqëruar nga mbrojtësi i tij, u paraqit për intervistë me ZPS-në. Parashtruesi pohon se mbrojtësi i tij nuk ishte në gjendje t'ia ofronte këshillat e duhura për shkak se nuk i ishin bërë të njohura detajet e pretendimeve kundër Parashtruesit. Rrjedhimisht, Parashtruesi ushtroi të drejtën për të mbajtur heshtje.<sup>11</sup>

### III. SHKELJET E PRETENDUARA

8. Parashtruesi ankohet se në fletëthirrjen e ZPS-së urdhërohej që, si i dyshuar, të paraqitej për marrje në pyetje dhe se procedura e marrjes në pyetje ishte e paligjshme dhe, si e tillë, e papranueshme. Konkretisht, ZPS-ja nuk kishte bërë të njohur veprën penale për kryerjen e së cilës dyshohej Parashtruesi dhe nuk kishte bërë të njohura provat mbi të cilat bazohej ky dyshim.<sup>12</sup>

9. Në lidhje me sa më lart, Parashtruesi mbështetet në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa").<sup>13</sup> Ai gjithashtu mbështetet në nenet 19(2), 21(4)(a) dhe 38(3)(a) të Ligjit dhe në rregullën 43(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës.<sup>14</sup>

---

<sup>10</sup> Kërkesa referuese, para. 2.5-2.10; Përgjigjja e ZPS-së, para. 3, shtojca konfidenciale 2 e saj (mesazh elektronik i ZPS-së dërguar mbrojtësit të Parashtruesit i datës 14 tetor 2019).

<sup>11</sup> Kërkesa referuese, para. 2.13-2.15; Përgjigjja e ZPS-së, para. 31, shtojca konfidenciale 3 e saj (transkripti i intervistës së datës 17 tetor 2019).

<sup>12</sup> Kërkesa referuese, para. 1.2-1.3, 4.22.

<sup>13</sup> Kërkesa referuese, para. 5.2-5.4.

<sup>14</sup> Kërkesa referuese, para. 3.1-3.9, 5.1.

#### IV. JURIDIKSIONI

10. Dhoma vëren se kërkesa referuese është paraqitur në pajtim me nenin 113(7) të Kushtetutës. Në kërkesën referuese, Parashtruesi ankohet në lidhe me fletëthirrjen dhe procedurën e marrjes në pyetje nga ZPS-ja. Domethënë, kërkesa referuese ka të bëjë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, siç kërkohet në nenin 162(3) të Kushtetutës dhe nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Rrjedhimisht, Dhoma ka juridiksion për të vendosur mbi kërkesën referuese.

#### V. PRANUESHMËRIA

##### A. PARASHTRIMET

11. Prokurori i Specializuar pretendon se Parashtruesi nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të disponueshme siç përcaktohet në nenin 113(7) të Kushtetutës dhe nenin 49(3) të Ligjit. Konkretisht, Parashtruesi nuk i ka kërkuar Kryetares së Dhomave të Specializuara që, në pajtim me nenin 33(2) të Ligjit, të caktojë një gjykatës të vetëm për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Gjithashtu, sipas nenit 39(1), (3) dhe (10) të Ligjit dhe rregullës 48(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, një gjykatës mund t'i shqyrtojë çështjet e ngritura në kërkesën referuese. Për më tepër, Parashtruesi nuk përmend dispozitat kushtetuese konkrete që pretendon se janë shkelur nga fletëthirrja dhe procedura e marrjes në pyetje nga ZPS-ja, si edhe ngre çështje që janë jashtë juridiksionit të Dhomës.<sup>15</sup>

12. Në kundërpërgjigjen e tij, Parashtruesi nuk pajtohet me argumentet e Prokurorit të Specializuar. Ai parashtron se shqyrtimi nga një gjykatës i vetëm nuk është mjet juridik efektiv meqenëse çështjet e ngritura në kërkesën referuese janë jashtë fushëveprimit të atij shqyrtimi.<sup>16</sup>

---

<sup>15</sup> Përgjigjja e ZPS-së, para. 8-16; KSC-CC-2019-07, F00012, Përgjigjja e Prokurorisë ndaj parashtrimit të protokolluar KSC-CC-2019-07/F00009, publike, 17 dhjetor 2019, para. 2-3.

<sup>16</sup> KSC-CC-2019-07, F00009, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës referuese të z. Driton Lajçi drejtuar Gjykatës Kushtetuese, publike, 9 dhjetor 2019, para. 8-16.

## B. VLERËSIMI I DHOMËS

## 1. E drejta kushtetuese që kontestohet

13. Së pari, Dhoma duhet të përcaktojë se për të cilat të drejta kushtetuese të Parashtruesit bëhet fjalë në kërkesën referuese. Në këtë drejtim, Dhoma vë në dukje ankesën e Parashtruesit se ZPS-ja nuk e kishte informuar atë para intervistës, si i dyshuar, për detajet e dyshimit kundër tij dhe nuk ia kishte bërë të njohura provat mbi të cilat bazohet ky dyshim. Në lidhje me këtë, Parashtruesi mbështetet në nenin 6 të Konventës, i cili përcakton të drejtën për gjykim të drejtë (shih paragrafin 9 më lart).

14. Dhoma vëren se, bazuar në nenin 22(2) të Kushtetutës, neni 6 i Konventës zbatohet në nivel kushtetues.<sup>17</sup> E drejta për gjykim të drejtë përcaktohet edhe në nenin 31 të Kushtetutës. Për sa i takon ankesës së Parashtruesit veçanërisht për mungesën e informacionit në lidhje me dyshimin kundër tij, kjo lidhet me të drejtat minimale të njoftimit për akuzat dhe të përgatitjes së mbrojtjes, përcaktuar në nenin 6(3)(a),(b) të Konventës dhe nenin 30(1), (3) të Kushtetutës.<sup>18</sup> Njëkohësisht, këto të drejta minimale përbëjnë aspekte specifike të konceptit të gjykimit të drejtë në procedura penale në nenin 6(1) të Konventës dhe nenin 31(2) të Kushtetutës.<sup>19</sup>

15. Në bazë të sa më lart, duke qenë autoriteti përfundimtar që bën cilësimin juridik të fakteve të çështjes që ka në shqyrtim,<sup>20</sup> Dhoma konstaton se kërkesa referuese duhet

<sup>17</sup> Për sa i përket përfshirjes së Konventës me Protokollet e saj në ligjin e Kosovës në nivel kushtetues, shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Qemajl Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit*, KO 01/09, Aktgjykim, 27 janar 2010 (18 mars 2010), para. 40.

<sup>18</sup> Shih GJEDNJ, *Mattoccia v. Italy*, nr. 23969/94, GJEDNJ 2000-IX, para. 60; *Sadak and Others v. Turkey (no. 1)*, nr. 29900/96 dhe 3 të tjerë, GJEDNJ 2001-VIII, para. 50. Të gjitha citimet nga jurisprudenca në këtë Vendim i referohen jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ"), përveçse kur specifikohet ndryshe.

<sup>19</sup> Shih *Mattoccia v. Italy*, cituar më lart, para. 58; *Gäfgen v. Germany* [GC], nr. 22978/05, GJEDNJ 2010, para. 169. Shih gjithashtu *Dvorski v. Croatia* [GC], nr. 25703/11, GJEDNJ 2015, para. 76 *in fine*.

<sup>20</sup> Shih *Logachova and Others v. Ukraine*, nr. 4510/05 dhe 3 të tjerë, 10 dhjetor 2009, para. 10; *Margaretić v. Croatia*, nr. 16115/13, 5 qershor 2014, para. 75. Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*, Rev. 308/2007, 10 qershor 2010, KI 120/10, Aktgjykim, 29 janar 2013 (8 mars 2013), para. 50.

të shqyrtohet përkatësisht në pajtim me nenet 30(1), (3) dhe 31(2) të Kushtetutës, dhe nenin 6(1), (3)(a),(b) të Konventës.

## 2. Fushëveprimi i shqyrtimit

16. Dhoma më tej vëren ankesën e Parashtruesit se fletëthirrja dhe procedura e marrjes në pyetje nga ZPS-ja janë gjithashtu në mospërputhje me nenet 19(2), 21(4)(a) dhe 38(3)(a) të Ligjit dhe rregullën 43(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (shih paragrafin 9 më lart).

17. Në lidhje me sa më lart, Dhoma rithekson se sipas nenit 113(7) të Kushtetutës mbi bazën e të cilit është paraqitur kërkesa referuese, individët kanë të drejtë t'i referojnë Dhomës shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara në Kushtetutë. Siç del nga konstatimet e Dhomës në *Vendimin mbi referimin e Mahir Hasanit*, nëpërmjet mekanizmit të referimeve kushtetuese individuale, Dhoma ushtron juridiksion mbikëqyrës mbi procedurat para Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar për sa i takon përmbushjes prej tyre të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë.<sup>21</sup>

18. Në këtë kontekst dhe në përputhje me nenin 49(1) dhe (3) të Ligjit, detyra e kësaj Dhome është të vlerësojë nëse parregullsitë për të cilat ka paraqitur ankesë Parashtruesi kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tij si individ të garantuara në Kushtetutë. Nuk është detyrë e kësaj Dhome të trajtojë gabime të pretenduara faktike ose ligjore që pretendohet të jenë bërë gjatë procedurave penale, përveçse dhe vetëm

---

<sup>21</sup> KSC-CC-2019-05, F00012, Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018, publik, 20 shkurt 2019, para. 24 ("*Vendimi mbi Referimin e Mahir Hasanit*"). Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433/DO-318*, KO 26/15, Aktgjykim, 14 prill 2015, para. 65 *in fine*.

nëse këto gabime mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë.<sup>22</sup>

19. Nga zbatimi i parimeve të lartpërmendura në çështjen aktuale, rrjedh se nuk është detyrë e kësaj Dhome të vendosë nëse fletëthirrja ose procedura e marrjes në pyetje nga ZPS-ja përbëjnë shkelje të Ligjit ose të Rregullores së Procedurës dhe të Provave. Dhoma mund të shqyrtojë vetëm nëse mospërbushja e pretenduar prej ZPS-së e dispozitave përkatëse të Ligjit ose të Rregullores së Procedurës dhe të Provave përbën shkelje të së drejtës së Parashtruesit për gjykim të drejtë të garantuar në Kushtetutë.

20. Gjithsesi, para se të merret me këtë diskutim, Dhoma së pari duhet të vlerësojë nëse kërkesa referuese është e pranueshme.

### 3. Konstatimet mbi pranueshmërinë

21. Siç theksohet më lart, kërkesa referuese shqyrtohet përkatësisht në bazë të neneve 30(1), (3) dhe 31(2) të Kushtetutës 6(1), dhe nenit (3)(a),(b) të Konventës. Dhoma rithekson se, për sa u takon çështjeve penale, qëllimi kryesor i nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës është që një të akuzuari t'i garantohet në tërësi gjykim i drejtë nga një gjykatë kompetente për të vendosur në lidhje me një akuzë penale.<sup>23</sup> Në mënyrë të ngjashme, garancitë minimale në bazë të nenit 30(1), (3) të Kushtetutës dhe nenit 6(3)(a),(b) të Konventës nuk janë qëllime në vetvete: qëllimi i

---

<sup>22</sup> *Vendimi mbi Referimin e Mahir Hasanit*, para. 50. Shih *Bochan v. Ukraine* (nr. 2) [GC], nr. 22251/08, GJEDNJ 2015, para. 61; *Perez v. France* [GC], nr. 47287/99, GJEDNJ 2004-I, para. 82. Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml No. 225/2017 të 18 dhjetorit 2017*, cituar më lart, para. 38; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 44/2018, të 10 prillit 2018*, KI 72/18, Aktvendim për papranueshmëri i 22 nëntorit 2018 (14 dhjetor 2018), para. 40; *Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës Supreme, Nr. 2407/2006 të 30 shtatorit 2009*, KI 55/09, Aktgjykim, 13 dhjetor 2010 (6 prill 2011), para. 18, 21.

<sup>23</sup> Shih, për shembull, *Dvorski v. Croatia*, cituar më lart, para. 76; *Nikolova v. Bulgaria* (dec.), nr. 31195/96, 27 shkurt 1997; *Guliyev v. Azerbaijan* (dec.), nr. 35584/02, 27 maj 2004.



qenësishëm i tyre gjithmonë është që të kontribuojnë në garantimin e drejtësisë së procedurave penale në tërësi.<sup>24</sup>

22. Në çështjen aktuale, kërkesa referuese ka të bëjë me një fazë fillestare të procedurave penale, konkretisht me intervistën me ZPS-në e cila ende është duke kryer hetime. Si rrjedhojë, kërkesa referuese nuk ka të bëjë me gjykim para një gjykate në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës apo nenit 6 të Konventës. Dhoma gjithashtu vëren se ndryshe nga *Vendimi mbi referimin e Mahir Hasanit*,<sup>25</sup> Parashtruesi në çështjen aktuale nuk është ankuar se është kërcënuar me masë ndëshkimore për shkak të refuzimit për t'i dorëzuar prova ZPS-së.

23. Njëkohësisht, Dhoma pajtohet se në të vërtetë neni 30 i Kushtetutës dhe neni 6(3) i Konventës mund të jenë të rëndësishëm para se çështja të çohet për gjykim. Megjithatë, kjo zbatohet “nëse dhe vetëm kur drejtësia e gjykimit mund të cenohet rëndë nga mospërmbushja që në fillim e [atyre] dispozitave”.<sup>26</sup> Duke qenë se nuk ka pasur asnjë gjykim, Dhoma në këtë fazë nuk mund të hamendësojë nëse dhe si do të ndikojnë - nëse do të kenë ndonjë ndikim - fletëthirrja dhe marrja në pyetje që kundërshtohen nga Parashtruesi, mbi drejtësinë e gjykimit në tërësi, nëse do të zhvillohet një i tillë.<sup>27</sup> Në lidhje me këtë, Dhoma nuk mund të mos vërejë se Parashtruesi e ka ushtruar të drejtën e mbajtjes së heshtjes.

24. Edhe sikur të zhvillohet gjykim, gjë që nuk dihet ende, Parashtruesi do të ketë mundësi të paraqesë para paneleve kompetente çështjen e gjykimit të drejtë në lidhje me fletëthirrjen dhe procedurën e marrjes në pyetje, të kundërshtuara prej tij. Në këtë aspekt, Dhoma pajtohet me ZPS-në (shih paragrafin 11 më lart) se Parashtruesi gjithashtu do të ketë mundësi t'i paraqesë këto çështje para një gjykatësi të procedurës

---

<sup>24</sup> *Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], nr. 50541/08 dhe 3 të tjerë, 13 shtator 2016, para. 251.

<sup>25</sup> *Vendimi mbi Referimin e Mahir Hasanit*, para. 41 et seq.

<sup>26</sup> *Vendimi mbi Referimin e Mahir Hasanit*, para. 39; *Ibrahim and Others v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 253; *Dvorski v. Croatia*, cituar më lart, para. 76.

<sup>27</sup> *Vendimi mbi Referimin e Mahir Hasanit*, para. 39-40. Shih *Nikolova v. Bulgaria*, cituar më lart; *Guliyev v. Azerbaijan*, cituar më lart.

paraprake, nëse caktohet një i tillë, në përputhje me nenin 39 të Ligjit. Përveç kësaj, Dhoma thekson se pas një vendimi të formës së prerë në procedurë penale, nëse do të ketë një të tillë, Parashtruesi mund t'ia paraqesë përsëri ankesat e tij kësaj Dhome, në qoftë se ende e konsideron veten viktimë të shkeljeve të pretenduara.

25. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma konstaton se, nga këndvështrimi i neneve 30(1), (3) dhe 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1), (3)(a),(b) të Konventës, kërkesa referuese është e parakohshme dhe si e tillë duhet të shpallet e papranueshme.

26. Ndonëse konstaton se kërkesa referuese duhet të refuzohet për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e gjykon të përshtatshme të trajtojë argumentin e ZPS-së se para se t'i drejtohej kësaj Dhome, Parashtruesi duhej t'i kishte shterur mjetet juridike të parapara në nenin 33(2) të Ligjit (shih paragrafin 11 më lart).

27. Në këtë drejtim, Dhoma thekson se për të shteruar një mjet juridik të paraparë në nenin 113(7) të Kushtetutës dhe nenin 49(3) të Ligjit, ai duhet të jetë *efektiv*. Kjo do të thotë që mjeti juridik duhet të jetë i qasshëm dhe të mundësojë shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë. Ekzistenca e një mjeti juridik efektiv duhet gjithashtu të jetë mjaftueshmërisht e sigurt.<sup>28</sup>

28. Duke i zbatuar parimet e mësipërme në procedurën e paraparë në nenin 33(2) të Ligjit,<sup>29</sup> Dhoma vëren se kjo mundësi shqyrtimi nuk i përngjan një procedure të

<sup>28</sup> Shih *Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina* [GC], nr. 2312/08 dhe 34179/08, GJEDNJ 2013, para. 58; *Mocanu and Others v. Romania* [GC], nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, GJEDNJ 2014, para. 222; *Paksas v. Lithuania* [GC], nr. 34932/04, GJEDNJ 2011, para. 75; *Sejdovic v. Italy* [GC], nr. 56581/00, GJEDNJ 2006-II, para. 45; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0123, të 30 nëntorit 2017*, KI 61/18, Aktvendim për papranueshmëri, 16 janar 2019 (19 shkurt 2019), para. 53.

<sup>29</sup> Në pjesën përkatëse të nenit 33(2) të Ligjit lexohet si më poshtë:

[...] Kryetari [i Dhomave të Specializuara] gjithashtu mund të caktojë një gjyqtar të vetëm nga regjistri [...] për t'u marrë me ndonjë çështje që, sipas mendimit të Kryetarit, kërkon caktimin e një gjyqtari dhe jo të gjyqtarit të procedurës paraprake (panel i një gjykatësi të vetëm). [...] (theksimi i shtuar)

rregullt apeli. Së pari, është e paqartë nëse parashtruesi ka mundësi qasjeje të drejtpërdrejtë në një shqyrtim të tillë.<sup>30</sup> Neni 33(2) parasheh që Kryetari i Dhomave të Specializuara “mund” të caktojë një gjykatës të vetëm në qoftë se, “sipas mendimit” të Kryetarit, kërkohet një caktim i tillë (për dallim nga “do të caktojë” në nenin 33(1), (3) të Ligjit). Nga kjo rrjedh që Kryetari mund të vendosë edhe që të mos caktojë një gjykatës të vetëm. Rrjedhimisht, ky shqyrtim nuk kryhet automatikisht me paraqitjen e ankesës nga parashtruesi. Së dyti, në jurisprudencën e saj, GJEDNJ-ja ka specifikuar se për të qenë efektiv, mjeti juridik duhet të ketë afate kohore të përcaktuara qartë.<sup>31</sup> As Ligji dhe as Rregullorja e Procedurës dhe e Provave nuk specifikojnë një afat kohor brenda të cilit parashtruesi mund t’i kërkojë Kryetarit që të caktojë një gjykatës të vetëm. Mungesa e një afati kohor gjithashtu krijon paqartësi dhe e bën të pavlefshëm afatin dymujor për paraqitjen e një kërkesë referuese para Dhomës, paraparë në rregullën 20(1)(b) të Rregullores së Punës.

29. Dhoma gjithashtu vëren se Ligji ose Rregullorja e Procedurës dhe e Provave mund të ishin më të qarta për sa i takon fushëveprimin të shqyrtimit prej një gjykatësi të vetëm të caktuar sipas nenit 33(2) të Ligjit, në mënyrë që parashtruesi të sigurohet se ai ka të bëjë me shkeljet e pretenduara. Megjithëse Dhoma mund të pranojë se kjo mund të qartësohet edhe nga praktika gjyqësore, konsideratat e lartpërmendura në lidhje me qasjen në procedurë dhe afatet kohore nuk i lejojnë Dhomës të nxjerrë përfundimin se kjo procedurë ishte një mjet juridik që duhej marrë parasysh për qëllimet e nenit 113(7) të Kushtetutës dhe nenit 49(3) të Ligjit.

30. Për këto arsye, Dhoma e gjykon të përshtatshme që ta refuzojë kërkesën referuese si të parakohshme. Në këtë fazë të procedurave, kërkesa referuese nuk të

---

<sup>30</sup> Shih *Williams v. the United Kingdom* (dec.) nr. 32567/06, 17 shkurt 2009; *Rizi v. Albania* (dec.), nr. 49201/06, 8 nëntor 2011, para. 44. Shih gjithashtu *Galstyan v. Armenia*, nr. 26986/03, 15 nëntor 2007, para. 41.

<sup>31</sup> *Williams v. the United Kingdom*, cituar më lart; *Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd and Others v. Georgia*, nr. 16812/17, 18 korrik 2019, para. 267; *Rizi v. Albania*, cituar më lart, para. 44; *Galstyan v. Armenia*, cituar më lart, para. 39.

bën të mendosh se ka shkelje të së drejtës së Parashtruesit për gjykim të drejtë sipas neneve 30(1), (3) and 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1), (3)(a),(b) të Konventës. Rrjedhimisht, Kërkesa referuese duhet të shpallet e papranueshme në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores.

## VI. KLASIFIKIMI

31. Siç u theksua më lart, Prokurori i Specializuar kërkoi riklasifikimin e kërkesës referuese prej publike në konfidenciale (shih paragrafin 3 më lart). Me vendimin e përmbledhur të datës 20 nëntor 2019, Dhoma e refuzoi këtë kërkesë. Dhoma gjithashtu theksoi se arsyet për këtë do t'i parashtronte në vendimin e saj mbi kërkesën referuese.<sup>32</sup> Rrjedhimisht, këto arsye Dhoma i parashtron si më poshtë.

32. Dhoma thekson se karakteri publik i dokumentacionit të saj lidhet drejtpërsëdrejti me parimin themelor të administrimit publik të drejtësisë, mishëruar në nenin 31(2) dhe (3) të Kushtetutës. Ky parim themelor i mbron personat përkatës nga administrimi në fshehtësi i drejtësisë, pa mbikëqyrje nga publiku. Ai gjithashtu shërben edhe për ruajtjen e besimit tek Dhoma.<sup>33</sup> Dhoma gjithashtu vë në dukje aspektet vijuese që tregojnë se pse karakteri publik i dokumentacionit të saj ka rëndësi të veçantë. Së pari, Dhoma trajton çështje kushtetuese që bartin rrjedhoja për sistemin ligjor të Dhomave të Specializuara. Për këtë arsye, pritshmëria që punimet të jenë publike është e lartë. Së dyti, Dhoma përgjithësisht vendos për çështjet që i shqyrton me anë të një procedure me shkrim, dhe jo me gojë. Megjithëse kjo në vetvete nuk përbën problem, duke qenë se shqyrtimi i Dhomës përqendrohet në çështje të kushtetutshmërisë,<sup>34</sup> dokumentacioni publik është thelbësor për ruajtjen e transparencës së procedurave të saj me shkrim.

---

<sup>32</sup> KSC-CC-2019-07, F00007, Përmbledhje e vendimit lidhur me kërkesën e Prokurorisë për riklasifikimin e parashtrimit KSC-CC-2019-07/F00001, publike, 20 nëntor 2019, para. 5.

<sup>33</sup> Në lidhje me këtë, shih *Martinie v. France* [GC], nr. 58675/00, GJEDNJ 2006, para. 39; *Juričić v. Croatia*, nr. 58222/09, 26 korrik 2011, para. 84.

<sup>34</sup> Shih *Meimanis v. Latvia*, nr. 70597/11, 21 korrik 2015, para. 48 *et seq.*

33. Për këto arsye, Dhomës duhet t'i jepen arsye bindëse për të devijuar nga karakteri publik i dokumentacionit të saj. Në veçanti, në rastet kur kjo është e domosdoshme për të mbrojtur interesa të tjerë të rëndësishëm që rrezikohen, si për shembull, privatësinë ose sigurinë e një personi, të fëmijëve apo personave të tjerë të cenueshëm, ose materiale hetimore konfidenciale, apo kur publiciteti do të cenonte interesat e drejtësisë.

34. Në çështjen aktuale, ZPS-ja i kërkoi Dhomës riklasifikimin e kërkesës referuese prej publike në konfidenciale për të ruajtur konfidencialitetin dhe integritetin e hetimit në kryerje e sipër.<sup>35</sup> Në lidhje me këtë, Dhoma vëren se vetë ZPS-ja vendosi që në këtë fazë të procedurave ta ftonte Parashtruesin për intervistë dhe ta informonte për hetimin që po kryhet. Rrjedhimisht, ishte vendimi i ZPS-së që ta nxirrte atë informacion. Lidhur me këtë, Dhoma gjithashtu thekson se mediat tashmë kanë botuar informacion për marrjen në pyetje të Parashtruesit nga ZPS-ja.<sup>36</sup>

35. Gjithashtu, informacioni që përmban kërkesa referuese për hetimin është i natyrës së përgjithshme. Ai nuk identifikon pretendime faktike, prova, dëshmitarë ose deklarata të tyre, apo masa hetimore. Rrjedhimisht, Dhoma nuk është në gjendje të përcaktojë se si klasifikimi i kërkesës referuese si publike rrezikon integritetin e hetimit, sidomos kur ZPS-ja nuk ka paraqitur arsye konkrete në këtë drejtim.

36. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma vendosi më 20 nëntor 2019<sup>37</sup> të refuzojë kërkesën e ZPS-së për riklasifikim.

---

<sup>35</sup> KSC-CC-2019-07, F00003, RED, Version publik i redaktuar i Kërkesës së Prokurorisë për riklasifikimin e parashtrimit KSC-CC-2019-07/F00001', publik, 15 nëntor 2019, publik i redaktuar, 18 nëntor 2019, para. 1.

<sup>36</sup> Shih, për shembull, "Hague Prosecutors quizzed Kosovo Justice Ministry Official"/"Prokurorët e Hagës marrin në pyetje një zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës", 21 tetor 2019, *Gazeta Express* <<https://www.gazetaexpress.com/hague-prosecutors-quizzed-kosovo-justice-ministry-official/>> (qasur më 13 janar 2020).

<sup>37</sup> KSC-CC-2019-07, F00007, Përmbledhje e vendimit lidhur me kërkesën e Prokurorisë për riklasifikimin e parashtrimit KSC-CC-2019-07/F00001, publike, 20 nëntor 2019.

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

*E deklaron* të papranueshme kërkesën referuese në lidhje me fletëthirrjen dhe procedurën e marrjes në pyetje që zbaton Zyra e Prokurorit të Specializuar.

/nënshkrim/

**Vidar Stensland**

**Kryetar**

Hartuar në anglishte, e hënë, 13 janar 2020

Në Hagë, Holandë